

Abdulla HAMITI¹

MBI POEZINË “BAHARIJE” TË PRISHTINELI MESIHIT

Abstrakt

Mesihi është një poet original në radhët e poetëve të poezisë së Divanit. Fantazia, origjinaliteti dhe thellësia e mendimeve ia mundësuan poetit që të krijojë një stil të veçantë, stil që karakterizohet me një shprehje më të pastërt. Në mesin e vjershave të Divanit të tij dallohet vjersha e titulluar "Baharije" (Këngë për pranverën). Në këtë vjershë ndjehet një origjinalitet në përshkrimin e pranverës, e cila në kohën e tij ishte shumë e popullarizuar. Poezia përbëhet prej njëmbëdhjetë strofave, në të cilat tre vargjet e para rimojnë mes veti dhe vargu i katërt si refren përsëritet në të gjitha strofat. Bie në sy se rimat te strofa e parë dhe e fundit janë të njëjta. Gjithashtu, shikuar si formë kjo është një poezi e shkruar në strofa dhe nuk është kaside, e në kohën e tij ishte zakon që përshkrimi i pranverës të bëhej në pjesën hyrëse të kasides së quajtur *Nesib* apo *Teshbib*. Në këtë shkrim do ta analizojmë poezinë "Baharije" dhe do ta japim edhe në origjinal edhe në përkthim.

Fjalë kyçe: *Prishtineli Mesih, Baharije, letërsia e Divanit*

¹ Profesor i gjuhës dhe letërsisë turke në Degën e Orientalistikës, Universiteti "Hasan Prishtina", Prishtinë.

Hyrje

Nuk është i vogël numri i poetëve tanë, të cilët u lindën dhe rininë e tyre e kaluan në Rumeli, por për ta ndjekur shkollimin shkuan në Stamboll dhe atje u dalluan në fushën e letërsisë dhe në dijet e tjera shkencore. Njëri prej tyre është edhe poeti i njohur i shekullit XV, Prishtineli Mesihi (Mesihi i Prishtinës). Emri i vërtetë i tij ishte Isa, ndërsa Mesihi është mahlas (emri poetik) i tij.

Sipas kronistëve dhe biografëve turq, Mesihi ishte nga Prishtina, e që në moshë të re ka shkuar në Stamboll, ku edhe fillon studimet në Medrese dhe aty e ka mësuar edhe artin e kaligrafisë. Suksesi në kaligrafi dhe dashuria e tij për këtë art, poetit i ndihmoi të fitojë popullaritet dhe hyri në shërbim të vezirit të madh Hadim Ali Pashës² si sekretar (qatip) i kancelarisë së tij, i cili u bë mbrojtësi i vetëm i Mesihihit. Por, për fat të keq, poeti, i cili për nga natyra ishte një personalitet boem, qejfli, i pakujdesshëm dhe jetën e kalonte me këngë, me pije dhe me argëtime e kënaqësi në shoqëri me bukuroshe, nuk ka arritur sukses të madh në shërbim në oborrin mbretëror. Jeta e tillë e kaluar është shprehur në tematikë të poezisë së tij. Edhe pse pashait këto gjëra nuk i pëlqenin fare, ai nga respekti që kishte për të, bëhej sikur nuk i shihte këto gjëra. Sipas fjalëve të Ashik Çelebiut³, kurdo që pashai e kërkonte për t'i dikutar për të shkruar diçka, nuk e gjente në vend të punës dhe me fjalët: “Gjejeni atë djalë të qytetit”, urdhëronte ta kërkojnë. Rojtarët, të cilë dilnin për ta kërkuar, shpesh e gjenin ose në vendet e zbatimit në Tahtakale ose në ndonjë mejhane, ose në ndejat gazmore në kopsht, që i bënte me gratë e bukura.

² Hadim Ali Pasha ishte me prejardhje boshnjak, i cili si devshirme, ishte shkolluar në shkollën perandorake Enderun, pastaj kishte shërbyer disa herë si bejlerbej dhe dy mandate si veziri azam / kryeministër gjatë kohës së sulltan Bajezidi II gjatë viteve 1501-1503 dhe 1506 – 1511 kur edhe vdes në Amasya.

³ Filiz Kılıç, (hzl): *Âşık Çelebi, Meşâirü’ş-Şuarâ İnceleme-Metin*. C. 2. İstanbul: İstanbul Araştırmaları Enstitüsü, 2010, s. 809.

Pas vdekjes së Hadim Ali Pashës më 1511 në luftën kundër kryengritjes së shiive në Erdebil, Mesihi mbetet pa mbështetës, ndërsa rrjedha jetësore e Prishtinali Mesihit u përshkua me shumë ndryshime. Pas vdekjes së Hadim Ali Pashës, Mesihi në kërkim të një mbrojtësi tjetër i ka shkruar disa kaside lavdithurrëse agait të jeniçerëve, Junus Pashait dhe Nishanxhiut Xhafer Çelebi, dhe mbase për shkak të pasionit të tij për jetë të shfrenuar nuk ia doli ta fitojë simpatinë dhe mbrojtjen e tyre. Por, poetit i jepet një timar i vogël në Bosnje, ku edhe vdiq më 1512.

Mesihi është një poet origjinal në radhët e poetëve të poezisë së Divanit. Fantazia, origjinaliteti dhe thellësia e mendimeve ia mundësu- an poetit që të krijojë një stil të veçantë, stil që karakterizohet me një shprehje më të pastërt. Mesihi, gjithashtu, konsiderohet si lirik dhe poeti më i veçantë i periudhës së Mehmedit II. Po ashtu, është nga poetët më të dashur të poezisë së Divanit, i cili la një Divan, me rreth 350 poezi, *Shehregiz* - poemë e shkruar në formën poetike *mesnevi*, e përbërë nga 173 bejte, që i kushtohet qytetit të Edrenesë, duke e përshkruar jetën shoqërore përkatësisht 46 bukuroshet e qytetit dhe konsiderohet nismëtar i këtij lloji poetik në letërsinë klasike turke, dhe veprën *Gül-ü Sadberg* në prozë që përbëhet nga njëqind letra me tema të ndryshme.

Në mesin e vjershave të Divanit të tij dallohet kasidja e titulluar "Bahariyye" (Këngë për pranverën). Në këtë kasidë ndjehet një origjinalitet në përshkrimin e pranverës, e cila në kohën e tij ishte shumë e popullarizuar. Mbase ishte poezia e parë turke e përfshirë në një antologji të përkthyer latinisht me 1774, dhe kjo bëri që në Evropë të fillojë të shfaqej interesim i madh për letërsinë turke. Pastaj, kjo poezi përjeton përkthim në gjuhë të shumta evropiane. E, pikërisht, kjo poezi do të trajtohet në këtë shkrim tonin, ku pasi të japim shpjegimin për Baharijet (përshkrimet e pranverës) në letërsinë klasike turke do ta interpretojmë poezinë Baharije të Mesihit dhe do ta japim përkthimin e saj të shoqëruar edhe me origjinalin.

Përshkrimi i pranverës në poezinë klasike turke

Përshkrimi i pranverës ishte temë, pothuajse, e të gjithë poetëve të letërsisë klasike turke, sepse ajo pas një jete të zymtë, të mërzitshme, të mbyllyr brenda mureve të shtëpisë gjatë dimrit, simbolizonte gjallërinë, rilindjen, gëzimin për një jetë të lumtur e të hareshme. Përshkrimi i pranverës bëhet qoftë në një pjesë brenda kasides, qoftë me vjersha të tëra.

Kasida - është formë poetike, njëra nga më të përfaqësuarat në poezinë e Divanit, e cila shkruhet në bejte dhe mund të ketë 30 - 99 bejte, ndonëse mund të ketë kaside që përmbajnë më shumë e më pak bejte. Pra, kasidet janë poezi të shkruara me rregulla të caktuara me qëllim të lavdërimit të personaliteteve të mëdha fetare e shtetërore.

Kasidja përbëhet nga pesë pjesë kryesore: Nesîb-Teşbîb -është pjesa hyrëse e poezisë në cilën poeti, para se të hyjë në temën kryesore të kasides, shpreh gëzimin që e ndjen me rastin e ardhjes në post të personit, të cilin e lavdëron; ku flet për pranverën, për bajramin, dimrin, verën, zbavitjen dhe e bën përshkrimin e tyre; nganjëherë këtu përshkruhet dashuria, vuajtjet nga dashuria, bukuria e të dashurës, pija apo cilësia e pijes; dhe si rrallë është shprehur edhe ndonjë mendim filozofik. Kjo është pjesa që kaisdeve u jep emrin; *Medhiye* - e që është pjesa kryesore e kasides, ku lavdërohet personi, të cilit i kushtohet kasidja; *Tegazzül* - është gazeli i futur brenda kasides i përshtatshëm me metrin dhe rimën e kasides, ku poeti ka për qëllim ta thejë monotoninë; *Fahriye* - është pjesa, ku poeti e lavdëron veten dhe poezinë, respektivisht artin e vet dhe *Duaja/Lutja* - është pjesa e fundit e kasides që përbëhet nga disa bejte, ku poeti lutet për personin, të cilit i kushtohet kasidja, si edhe për veten. Nuk është kusht që në një kaside të gjenden të gjitha këto pjesë. Mirëpo, duhet t'i përmbajë së paku dy nga këto pjesë.

Në burime është vënë theksi për ndarjen mes *nesîb*-it dhe *teşbîb*-it. “Pjesët hyrëse ku për temë është dashuria dhe e dashura, ku flitet për vuajtjet nga dashuria quhet *nesîb*; ndërsa pjesët të cilat flasin për temat

e tjera janë quajtur *teshbib*. Po ashtu, tregohet se këto janë përodrur edhe në vend të njëra-tjetrës, dhe si më e përhapura, është përdorur shprehja “nesib”. Ndërsa në ballë të temave të trajtuara në nesib qëndron përshkrimi i pranverës”.⁴

Përsa i përket numrit të bejteve në pjesën e nesibit të kasidet kryesisht sillet midis 5 -20 bejteve, ndonëse ka kaside që kanë nesib me më pak se 5 bejte, por edhe nesibe që i tejkalojnë 20 bejte.

Vjershat, të cilat për temë trajtimi e kanë stinën e pranverës në letërsinë klasike turke, quhen *bahâriyye* (këngë për pranverën). Pranvera është stinë në të cilën natyra përsëri ngjallet, kur drunjtë, bimët gjelbërohen dhe çelin lulet, kur ujërat vërshojnë, kur njerëzit ringjallen, duke u ndikuar nga ky gjallërim dhe nga kjo rilindje, shpëtojnë nga mundimi i dimrit dhe e arrijnë kënaqësinë, e gjithashtu është stinë, në të cilën organizohen tubime për zbavitjeje. Ndërsa, poetët në vjershat për pranverën bukuritë e pranverës i përshkruajnë me një gjuhë admirimi dhe të ekzagjeruar.⁵

Poetët në kasidet e tyre temën e pranverës, e cila e përfaqëson ngjalljen e sërishme, e kanë trajtuar shumë më tepër në krahasim me stinën e tjera.⁶ Gjithashtu, poetët kishin një këndvështrim negativ ndaj vjeshtës, sepse mendonin se vjeshta e përfaqësonte pleqërinë dhe rraskapitjen. Ndërsa, të këngët për dimrin (*şitâiyyeler*) të cilat janë vjersha që e përshkruajnë stinën e dimrit dhe të ftohtit, dimrin e përshkruajnë si simbol të rraskapitjes. Stina e dimrit përmendet bashkë me pleqërinë dhe vdekjen. Edhe në vjershat e quajtura *temmûziyye*, të cilat për temë trajtimi e kanë verën dhe vapën e verës, dominon një këndvështrim negativ. Poetët ankohen për atë se nxehtësia e verës e than tërë natyrën, se moti/ajri e ngulfat njeriun. Siç u pa, përkundër stinave të tjera, të

⁴ Aydemir, Yaşar. (2002), “Türk Edebiyatında Kaside, *Bilig*, S. 22, s. 46.

⁵ AKKUŞ, Metin (2006), *Klasik Türk Şiirinin Anlam Dünyası: Edebi Türler ve Tarzlar*, Erzurum: Fenomen Yay., s. 26.

⁶ Aydemir, Y. (2002), “Türk Edebiyatında Kaside, *Bilig*, S. 22, s. 46.

cilat asocojnë shkatërrimin, vdekjen, për poetët e Divanit ishte e natyrshe që në poezitë e tyre të përcaktohen të shkruajnë për të bukurën dhe për bukuritë e pranverës.⁷

Në poezinë osmane baharijet janë të rëndësishme, pasi tregojnë se si dukuritë në natyrë ndikojnë në imagjinatën e poetit dhe e tregojnë shkallën, në të cilën bashkëvepron natyra dhe njerëzimi me njëri-tjetrin. Në shoqërinë osmane stina e pranverës ndikon te poetët e artistët si në jetën e tyre të përditshme, ashtu edhe në jetën kulturore dhe luan një rol të rëndësishëm në formësimin e ndjeshmërisë estetike të artistit dhe të aktiviteteve kulturore të njerëzve. Marrëdhënia, që poetët osmanë krijojnë me natyrën, krijon një kuptim të pavarur estetik të pasur me simbole. Këto imazhe, përveç aludimeve për botën personale, përfshijnë edhe referenca për jetën shoqërore.⁸

Interesimi për përkthimin e poezisë “Baharije” të Mesihit

Bahariyye-t janë vjersha që kanë kënduar për pranverën dhe janë ndër zhanret më të njohura letrare në letërsinë klasike turke. Bukuritë e pranverës, rigjallërimi i natyrës, lumturia dhe freskimi që te njerëzit u shfaqën paralelisht me përtërirjen e natyrës dhe tubimet argëtuese, të cilat lindën si rezultat i kësaj, janë burime të rëndësishëm për të qenë njerëzit të lumtur, për të marrë kënaqësi nga jeta. Të gjitha këto në baharije (këngët për pranverën) janë portretizuar duke përdorur imazhe dhe metafora të pasura.

⁷ ZEYNEP ÖZ; *Bâkî Dîvânı'nda Bahâriyye*, Divan Edebiyatı Araştırmaları Dergisi 19, İstanbul 2017, 218.

⁸ Arzu KALENDER, “TAZE CAN BULDU CİHAN”: OSMANLI ŞİİRİNDE BAHAR, Bilkent Üniversitesi Ekonomi ve Sosyal Bilimler Enstitüsü Türk Edebiyatı Disiplininde Master Derecesi Kazanma Yükümlülüklerinin Parçasıdır, TÜRK EDEBİYATI BÖLÜMÜ Bilkent Üniversitesi, Ankara Haziran 2002, s. v. <http://www.thesis.bilkent.edu.tr/0002026.pdf>

Edhe Mesihi, i cili konsiderohet si njëri nga poetët, që kontribuan shumë në zhvillimin e poezisë në periudhën, kur poezia e divanit e fitoi formën klasike, ka shkruar poezi edhe në zhanrin letrar bahariyye. Mesihi, i cili njihet si poet boem i lirikave të dashurisë në poezitë e tij, kryesisht i trajtonte temat e dashurisë, venës, tubimeve argëtuese, kënaqësisë së jetës. Për këtë arsye, baharije si përmbajtje është mjaft e përshtatshme për personalitetin e tij letrar.

Poezinë e tij për pranverën Mesihi e shkruan në formën murraba', pra në strofa katërvargëshe. Poezia përbëhet prej njëmbëdhjetë strofave, ku tre vargjet e para rimojnë mes veti dhe vargu i katërt si refren përsëritet në të gjitha strofat. Bie në sy se rimat te strofa e parë dhe e fundit janë të njëjta. Gjithashtu, shikuar si formë kjo është një poezi e shkruar në strofa dhe nuk është kaside, ku në kohën e tij ishte zakon, që përshkrimi i pranverës të bëhej në pjesën hyrëse të kasides të quajtur *Nesib* apo *Teshbib*.

Në vazhdim do ta analizojmë poezinë “Baharije” dhe do ta japim edhe në origjinal edhe në përkthim. Plot dyqind vite pas përkthimit të poezisë së Mesihit të quajtur *Bahariye* nga ana e Sir Williams Jones në gjuhën latine, në Evropë kishte filluar të shfaqet një interesim i madh ndaj letërsisë turke. Teksti turqisht i Baharijes i botuar në veprën e Jones-it, përkthimi latinisht në poezi dhe në prozë, ishte bërë bazë për përkthimin në gjuhët e tjera të Evropës, qoftë në shek. XVIII, qoftë për përkthimet e mëpastajmë. Në këtë mënyrë, përkthimi i vjershës së Mesihit dhe origjinali dhe përkthimet e Baharijes, kanë zënë vend në disa enciklopedi të përgjithshme dhe letrare të botuara në Evropë dhe në enciklopeditë e historisë botërore të letërsisë.⁹ Më 1774, orientalisti anglez, Sir Viliams Johns, botoi veprën “Antologjia e poezisë së Azisë”, ku ai shprehet se në lëtersinë turke vetëm Mesihi është ai që kishte thurur poezi për pranverën. Në këtë antologji V. Johnsi prezantoi poezinë

⁹ Ismail Eren, “Bahariye”nin Fransızca, Rusça ve Sırça Çevirileri, Türk Dili ve Edebiyatı Dergisi, c. 22, 1974-1976, İstanbul.

“Baharije” në origjinal dhe me përkthim në gjuhën latine. Në vitin 1787 këtë vjershë e ribotoi Toderini në veprën e vet “Letteratura Turchesca” e botuar në Venedik. Mandej në gjermanishte e përkthej Hammer Purgshtal. Dora D’Istria (1877), të cilën e njohim edhe për kah interesimi i saj për letërsinë popullore shqiptare, e përkthehu në gjuhën franceze, Misho e futi në biografinë e përgjithshme, Resheri (1941) dhe Annemari Shimel (1952) e përkthyen përsëri në gjuhën gjermane e më në fund Ettore Rossi në gjuhën italiane dhe botoi në “Oriente Moderno” pak para vdekjes. Pasandej, kjo poezi hyri në një antologji gjermane të vjershave më të bukura të poezisë botërore “Ofrej”. Fehim Bajraktareviqi përkthehu në gjuhën sërbo-kroate. Edhe kjo vjershë e Mesihut dallohet nga vjershat e kohës. Ajo është refleks i plotë i ndjenjave dhe i idealeve jetësore të Mesihut, ajo na e paraqet Mesihun e vërtetë, i cili ndodhej rrallë në vendin e punës, më shpesh nëpër kafenet e bahçet, e kjo është refleks i një botëkuptimi anakreon, fahizian. Si e tillë, duke pasur një notë të përgjithshme humaniste munda t’i kalonte kufitë e Turqisë¹⁰.

Përkthimi më i suksesshëm i kësaj poezie u bë në Beograd nga themeluesi i degës së orientalistikës Prof. Dr. Fehim Bajraktaroviç. Me të drejtë, Ismail Ereni thotë se Bajraktareviqi gjatë përkthimit të kësaj poezie kishte pasur kujdes të madh, për të mos iu shmangur origjinalitetit dhe i kishte kushtuar rëndësi të madhe ruajtjes së metrit dhe rimës. Edhe prof. H. Kaleshi thekson se kjo poezi mund të përkthehet edhe më mirë në gjuhën shqipe.

¹⁰ Hasan Kaleshi, *Roli i shqiptarëve në letërsinë orientale*, në: Seminari i kulturës shqiptare për të huaj, 2/1976, Prishtinë, Fakulteti Filozofik, fq. 159.

Sprovë për interpretimin e “Baharijes” së Mesihit

Poetët në botë, veçanërisht, në letërsinë islame i kushtojnë një vëmendje të veçantë stinës së pranverës dhe bukurive që sjell kjo stinë për njeriun. Në letërsinë klasike turke, këndimi për bukuritë e pranverës ka depërtuar nëpërmjet letërsisë perse, në të cilën mund të lexojmë krijimtari të pasur dhe shumë të bukur për këtë stinë, që sjell hare. Duhet të theksohet se një traditë e tillë e poezisë ka depërtuar edhe në letërsinë shqipe me alfabet arab dhe sidomos te Nezim Frakulla dhe Naim Frashëri, të cilët, bukurive pranverore i kanë kushtuar vargje e poezi të tëra. Pra, edhe Prishtineli Mesihi, poezinë e tij më të bukur ia ka kushtuar stinës së pranverës, të cilën do ta sjellim të përkthyer në vazhdim dhe do të mundohemi ta komentojmë:

Ndër shenjat dhe simbolet kryesore që lajmërojnë për ardhjen e pranverës padyshim se është bilbili, me zërin e tij të bukur, që sjell plot gjallëri dhe gëzim për njerëzit. Edhe Mesihi, poezinë e tij e fillon duke na këshilluar që ta dëgjojmë biblilin, i cili na përgëzon me lajmin e ardhjes së pranverës: *Dëgjo si këndon bilbili, ja erdhi pranvera.*

Bilbili me këngët e tij të bukura e melankolike, e gjallëron shpirtin e njeriut, i cili pas një dimri të gjatë e të lodhshëm, tani duhet të dalë në natyrë dhe ta fillojë punën dhe gjallërinë. Në vargun e dytë, poeti menjëherë kalon te simboli tjetër i pranverës, pra lulja dhe kopshti, të cilat, gjithashtu, ndikojnë në zgjimin dhe lulëzimin e natyrës në stinën e pranverës: Lulëzuan lulet në çdo kopsht, kudo vallja po luhet. Dhe *“Mund të thuhet se kopshti dhe shëtitjet që shihen si vende të kënaqësisë dhe të zbavitjes, bashkë me ardhjen e pranverës i përgjigjen nevojës së njerëzve që të hapen ndaj botës së jashtme dhe të rehatohen”*.¹¹

Nuk duhet harruar se bilbili dhe lulja (trëndafili) janë dhe dy motivet kryesore të letërsisë klasike persiane-turke, dhe kështu edhe të letërsisë shqipe të alhamiados. Në vazhdim, poeti na dëfton se nga

¹¹ Arzu Kalender, Ibid, s. 38.

gëzimi dhe hareja e ardhjes së pranverës, gjithandej po hidhet valle e po këndohet dhe në këtë mënyrë me shpejtësi po lulëzon çdo gjë në natyrë. Derisa poeti i sheh gjithë këto të mira dhe gëzime në pranverë, papritmas i bie ndërmend se kjo është një stinë, dhe si e tillë e shenon kohën, e cila do të kalojë, e me të simbolizon jetën, e cila është shumë e shkurtër dhe kalon shumë shpejt dhe shprehet: *Kush e di, kush i gjallë, kush i vdekur pret pranverën tjetër*, prandaj dhe nga lexuesi kërkon që sa më parë të marrë gotën e të pijë e të shijojë çdo moment të pranverës (jetës), ngase ajo kalon shumë shpejt dhe vjen ditë, a që do të vdesim. Strofën e përfundon me vargun: *Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera*, të cilin si refren autori e përsërit në fund të çdo strofe dhe duke vënë theksin në këtë koncept, ai dëshiron të na thotë se, kjo jetë duhet jetuar dhe shijuar, sepse është aq e shkurtër, saqë shumë shpejt ikën dhe vjen dita, kur edhe ne më nuk do të jemi në këtë botë.

Poeti, duke aluduar në dimrin, kur gjithçka është e fjetur apo edhe e vdekur paralajmëron ardhjen e pranverës, ku gjithçka gjallërohet, kur çelin lulet dhe bota zbukurohet. Dhe në përshkrimin e natyrës në pranverë më së shumti bëhen krahasime me lule. Madje, kur flitet për lulet përmenden me emra, si: trëndafil, tulipani etj. Dhe poeti shprehet:

*Kaloi koha kur bimët, të sëmura në tokë janë shtrirë,
Kur duke menduar në lulëzim, trëndafilët kanë ulur kokën,
Erdhi koha, kur tulipanët nëpër male kanë lulëzuar,
Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera. (strofa 7)*

Në vargjet e Mesihit shikojmë përshkrimin e erës së lehtë, të këndshme e të freskët. Era është frymëmarrje, e frymëmarrja domethënë jetë. Kështu, lulet e çelura, lagështia e vesës, por edhe shiu, zogjtë që këndojnë dhe argëtimi pa mbarim i fëmijëve në kopsht janë vepra e asaj ere. Prandaj, era e pranverës e dhuron jetën, pikërisht, sikur fryma

e profetit Isa. Ashtu siç Isa me frymën hyjnore që i ishte dhënë atij i ngjall të vdekurit, i shëron të sëmurit, ashtu edhe era e pranverës tokës së vdekur gjatë dimrit, tash i jep jetë. Ky motiv, në letërsinë klasike turke është i pranishëm shumë, pra “kur bimët ngjallen në stinën e pranverës, sepse i përtërirjes së botës lidhet me frymën e Isa-it, e cila i ngjall të vdekurit: *Era e pranverës, u bë falëse e shpirtit sikur Isa; lulet i hapën sytë nga gjumi i mosekzistencës*” shprehet poeti Baki 39¹².

Pra pranvera është erë, është shi, është bereqet, është lule. Pranvera është jetë, është ngjallje, është lumturi. Për këtë arsye poetët e divanit të dashurinë e kanë krahasuar me pranverën. Dhe këto i shohim në poezinë e Mesihit, kur shprehet:

*Kur reja mbi trëndafilishte çdo mëngjes lëshon margaritar shiu,
Kur në mëngjes aromë të bukur toka misk shpërthen,
Mos u bë i pakujdesshëm, derisa bota e tërë në dashuri gëzohet,
Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera.*

Duke u nisur nga konstatimi se “Pranvera nga shoqëria osmane është perceptuar si kohë e kënaqësisë dhe e zbavitjes dhe kishte kuptimin, që njeriu i atyre ditëve të harrojë çdo lloj vështirësi dhe ta përjetojë kënaqësinë e jetës”¹³, ne mund të konstatojmë se poeti ynë jetën e ka përshkruar si kënaqësi e zbavitje, duke sygjerruar të shfrytëzohet dhe të shijohen kënaqësitë e jetës që i sjell gjallërimi pranveror dhe në përshkrimin e pranverës ka përdorur një gjuhë të pasur me asocime e krahasime të ndryshme. Gjithashtu, mund të shihet se në këtë poezi të Mesihit, dominojnë fjalët lule, trëndafil, kopsht, pije, argëtim etj. të cilat mund të themi se janë fjalët kyçe në përshkrimin e pranverës në letërsinë klasike turke. Kjo poezi na e bën të njohur pikëpamjen

¹² Arzu Kalender, Ibid, s. 62

¹³ Arzu Kalender, Ibid, s. 66

jetësore të Mesihit me ndjenjat personale. Sikundër edhe përmendet, Mesih i dëshironte një jetë të shfrenuar dhe në vend se të qëndronte në vendin e tij të punës, ai preferonte që kohën ta kalojë në mejhane e nëpër kopshte dhe të përjetonte kënaqësi në natyrë e pranë bukurive të ndryshme.

Haiyya-i Bahariyye

1. Dinle bülbül kıssasın kim geldi eyyam-ı bahâr

Kurdı her bir bâğda hengâme-i bahâr

Oldı sim-efşân ana ezhar-ı bâdâm-ı bahâr

Ayş ü nuş et kim geçer kalmaz bu eyyâm-ı bahâr

1. *Dëgjo si këndon bilbili, ja erdhi pranvera,*

Lulëzuan lulet në çdo kopsht, kudo vallja po luhet,

Dhe prej drurit të bajamit vjen duke fluturuar argjend behari,

Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera.

2. Yine envâ'ı şükuf ile bezendi bâğ ü râğ

Ayş için kurdı çiçekler sahn-ı gülşende otağ

Kim bilür ol bir bahâra kim ölüp kim kala sağ

Ayş ü nuş et kim geçer kalmaz bu eyyâm-ı bahâr

2. *Përsëri me lule të ndryshme u zbukuruan kopshtet dhe vendet e zbavitjes,*

Për kënaqësi lulet ngriten çadrën midis trëdafilishtes,

Kush e di, kush i gjallë e kush i vdekur pret pranverën tjetër,

Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera.

3. Taraf-i gülşen Nur-ı Ahmed birle mâlâmâldır

Sebzeler anda Sahâbe lale hayrül-âldır

Hey Muhammed ümmeti! Vakt-i huzur-i hâldır

Ayş ü nuş et kim geçer kalmaz bu eyyâm-ı bahâr

3. *E gjithë trndafilishtja shndrit prej dritës së Ahmedit,*

Shoqëruesit (sahabët) janë bari i gjelbër e tulipanët lloj vyrtyti,

O ummeti i Muhammedit! Tani është koha për qejf e sefa,

Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera.

4. Kıldı şebnem girü cevherdar tig-i suseni

Lâleler aldı havâyı toblar ile gülşeni

Ger temâşâ ise maksudun beni esle beni

Ayş ü nuş et kim geçer kalmaz bu eyyâm-ı bahâr

4. *Vesa lulëshpatën e ka stolisur me perlë,*

Tulipant me topat nga qielli e kanë kapluar trëndafilishten,

Nëse dëshiron argëtim, m'i ndiq rregullat e mia,

Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera.

5. Ruhları rengin güzellerdir gül lâleler

Kim kulaklarına dürlü cevher asmış lâleler

Aldanup sanma ki bunlar böyle baki kalalar

Ayş ü nuş et kim geçer kalmaz bu eyyâm-ı bahâr

5. *Kush njeh fytyrë më të bukur se trëndafili e tulipani,*

Në veshët e atyre që tulipanët kanë varur perla të ndryshme,

Mos u mashtro e mos mendo se këto mbeten kështu përgjithmonë,

Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera.

6. Gülistânda görünen lâle ü gül nu'man ile

Bağda kan aldı şimşek neşter-i baran ile
Arif isen hoş geçür gel bu demi yârân ile
Ayş ü nuş et kim geçer kalmaz bu eyyâm-ı bahâr

6. *Në lulishte shihen tulipanë e trëndafil të kuq,*

*Sikur në kopsht rrufeja lëshon gjak me thikë prej shiu,
Në je i mençur, eja kaloje këndshëm këtë kohë me të dashurit,
Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera.*

7. Gitti ol demler ki olup sebzeler sâhib-firâş

Gonca fikri gülşenin olmuşdu bağrında baş
Geldi bir dem kim kızardı lâle ile dağ ü taş
Ayş ü nuş et kim geçer kalmaz bu eyyâm-ı bahâr

7. *Kaloi koha kur bimët, të sëmura në tokë janë shtrirë,*

*Kur duke menduar në lulëzim, trëndafilët kanë ulur kokën,
Erdhi koha, kur tulipanët nëpër male kanë lulëzuar,
Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera.*

8. Ebr gülzâr üstüne her subh gevherbâr iken

Nefha-i bâd-ı seher pür nâfe-i Tatar iken
Gâfil olma âlemin mahbublığı var iken
Ayş ü nuş et kim geçer kalmaz bu eyyâm-ı bahâr

8. *Kur reja mbi trëndafilishte çdo mëngjes lëshon margaritar shiu,*

*Kur në mëngjes aromë të bukur toka misk shpërthen,
Mos u bë i pakujdesshëm, derisa bota e tërë në dashuri gëzohet,
Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera.*

9. Buy-ı gülzâr etti şol denlû havâyı müşk-nâb
 Kim yere inince olur katre-i şebnem gülâb
 Çarh otak kurdı gülistan üstüne günlük sahâb
 Ayş ü nuş et kim geçer kalmaz bu eyyâm-ı bahâr

*9. Era e bahçes atë qiell e bëri misk të pastër,
 Dhe pikë vesë në tokë bie si lëng trëndafili nga qielli,
 E në lulishte qielli lëshon harkun prej temjanit të reve,
 Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera.*

10. Gülistânın her nesin aldı siyah bâd-ı hazân
 Adl edüp birbir ile vardı yine şâh-ı cihân
 Devletinde badeler kâm oldı sâkı kâmrân
 Ayş ü nuş et kım geçer kalmaz bu eyyâm-ı bahâr

*10. Era e vjeshtës vitin e kaluar, nga kopshti gjithçka mori,
 E mbreti i botës tani përsëri çdokujt drejtësinë i solli,
 Në pushtetin tënd ka rrjedhë venë e sakiu është ringjallë,
 Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera.*

11. Umarım bulup Mesihi bu murabba iştiḥâr
 Ola ehline bu çâr-ebru güzeller yadigâr
 Bülbül-i hoş-guy-sın gül yüzlülerle yûri var
 Ayş ü nuş et kım geçer kalmz bu eyyâm-ı bahâr

*11. Shpresoj famën e gjen Mesihi me këtë muraba',
 Si bukuritë me katër vetulla në kujtim do të jetojnë:
 Ti je bilbil që këndon bukur, kërko fytyrët që me trëndafil garojnë:
 Kënaqu e pi, sepse shpejt do të kalojë edhe pranvera.*

Literatura:

- AKKUŞ, Metin (2006), *Klasik Türk Şiirinin Anlam Dünyası: Edebi Türler ve Tarzlar*, Erzurum: Fenomen Yay.
- Arzu KALENDER, “TAZE CAN BULDU CİHAN”: OSMANLI ŞİİRİNDE BAHAR, *Bilkent Üniversitesi Ekonomi ve Sosyal Bilimler Enstitüsü Türk Edebiyatı Disiplininde Master Derecesi Kazanma Yükümlülüklerinin Parçasıdır, TÜRK EDEBİYATI BÖLÜMÜ Bilkent Üniversitesi, Ankara Haziran 2002, s. 38.*
<http://www.thesis.bilkent.edu.tr/0002026.pdf>
- AYDEMİR, Yaşar (2002), “Türk Edebiyatında Kaside”, *Bilig*, XXII, 133-168.
- Eren, İsmail (1977). “Bahâriyyenin Fransızca, Rusça ve Sırpça Çevirileri”. *İstanbul Üniversitesi Edebiyat Fakültesi Türk Dili ve Edebiyatı Dergisi* XXII: 221-227.
- Hasan Kaleshi, *Roli i shqiptarëve në letërsinë orientale*, në: Seminari i kulturës shqiptare për të huaj, 2/1976, Prishtinë, Fakulteti Filozofik.
- Mine Mengi (hızl), “Mesihî Divanı”, Ankara, Atatürk Kültür Merkezi Yay., 1995.
- ZEYNEP ÖZ (2017); Bâkî Dîvânı’nda Bahâriyye, *Divan Edebiyatı Araştırmaları Dergisi* 19, İstanbul, 217-254.

*Abdulla HAMITI*¹⁴

THE POEM "BAHÂRIYE" BY PRISHTINELI MESIHI

Summary

Mesihi is an authentic poet of Diwan poetry. His fantasy, originality and depth of thought enabled him to create a special style, a style that was characterized by a purer expression. Among the poems of his Diwan is the qasida called "Bahâriye" (Spring Poem). In this qasida however one feels an originality in the description of spring which in his time was very popular. The poem consists of eleven stanzas where the first three verses rhyme among themselves and the fourth verse as a refrain is repeated in all the stanzas. It is noticed that the rhymes in the first and last stanzas are the same. Also, viewed as a form this is a poem written in stanzas and is not a qasida which in his time was customary form used to describe spring in the introductory part of the qasida called Nesib or Te-shbib. In this article we will analyze the poem "Bahâriye" and we will give it both in the original and in the translation.

Key words: *Prishtineli Mesihi, Baharije, Divan poetry.*

¹⁴ Professor of Turkish Language and Literature in Department of Oriental Studies at University of Pristina, Pristina.

